

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT
“FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL” SH.A
NUIS L81530016L

VENDIM

Nr. 7, datë 30.12.2019

“Për emërimin e Administratorit të Shoqërisë”

Në mbështetje të nenit 154/f të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neneve 15, 16 dhe 18 të Statutit të shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A, Këshilli i Administrimit i shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A, në mbledhjen e datës 20.12.2019,

VENDOSI:

1. Z. Elton Sevrani emërohet Administrator i Shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A.
2. Marrëdhëniet e punës së Administratorit me Shoqërinë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A., fillojnë më datë 31.12.2019.
3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A, për ndjekjen e procedurave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elis BUSHATI

ELIS BUSHATI

[Signature]

ANËTAR
Ceno KLOSI

[Signature]

ANËTAR
Artur LAMA

[Signature]

Sekretare – Gentiana TOÇI

[Signature]

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT
“FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL” SH.A
NUIS L81530016L

VENDIM

Nr. 6, datë 30.12.2019

“Për lirim nga detyra të Administratorit të Shoqërisë”

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neneve 15, 16 dhe 18 të Statutit të shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A, Këshilli i Administrimit i shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A, pasi shqyrtoi kërkesën për dorëheqje të paraqitur nga Administratori i shoqërisë, me shkresën Nr Extra Prot, datë 27.12.2019

VENDOSI:

1. Z. Florenc Rama lirohet nga detyra e Administratorit të Shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A, me dorëheqjen e tij.
2. Në zbatim të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, të bëhen reflektimet përkatëse në regjistrin tregtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elis BUSHATI

Elis Bushati


ANËTAR
Ceno KLËSI



ANËTAR
Artur LAMA



Sekretare – Gentiana TOÇI



“OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE” SH.A

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

AKSIONARI I VETËM

VENDIM

Nr. 6 datë 20.12.2019

“Për emërim të audituesve ligjorë”

Në mbështetje të nenit 135/ç të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të nenit 12.3/d të Statutit të shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A., për të kontrolluar dhe certifikuar llogaritë vjetore për vitin 2019, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A, në mbledhjen e datës 20 12.2019,

VENDOSI:

1. Caktimin si auditues ligjorë, për të kontrolluar dhe certifikuar llogaritë vjetore për vitin 2019 të shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A, të audituesve:
 - Ilia ÇEÇE;
 - Ilda EKONOMI.
2. Shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A, para fillimit të punës, të nëshkruajë një kontratë me audituesit ligjorë për punën që do të kryhet, me përshkrimin e rubrikave e verifikimeve, kontrollove, raportimeve etj, për përmbushjen e misionit, orëve të punës të parashikuara si dhe honorarin gjithsej.
3. Përveç raportit standard të auditimit, audituesit ligjorë të shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A duhet të dorëzojnë në “OSHEE” Sh.A, relacionin shpjegues për të gjitha zërat e bilancit si dhe sugjerimet e tyre për shoqëritë në vështirësi financiare.
4. Ngarkohet Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” Sh.A. për zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
AKSIONARI I VETËM
ADMINISTRATORI I “OSHEE” SH.A**

Adrian ÇELA

OSHEE, sh.a.

Nr. 001